

NJOFTIM PËR KONSULTIM ME PUBLIKUN

Titulli : Konsultim publik për Planin vendor te Integritetit, 2025-2028, bashkia Delvinë.

Propozuesi i projektaktit: Kryetari i Bashkisë Z. Besmir Veli.

Qëllimi: Ky bashkëbisedim me banorët dhe grupet e synuara te Bashkisë Delvinë ka për qëllim mbledhjen e sugjerimeve të komunitetit lidhur me Planin Vendor te Integritetit, 2025-2028.

Kalendari i konsultimit: Konsultimi me komunitetin do të zhvillohet në Bashkinë Delvinë, sipas kalendarit më poshtë:

	Data	Ora	Vendi
Delvinë	08.08.2025	11.00	Salla e mbledhjeve të këshillit

Gjithashtu, sugjerimet e tyre janë të mirëpritura, në adresat e emaileve: panoreaballaci@outlook.com dhe keshilibashkiakdelvine@gmail.com

Linku i dokumentit: <https://www.bashkiadelvine.gov.al/projekt-akte-te-hapura-per-konsultim/>

Pjesëmarrës:

- Nga ana e Bashkisë: Këshilltarët e Këshillit Bashkiak, administrata e bashkisë
- Nga komuniteti: Banorët e Bashkisë Delvinë, organizata joqeveritare dhe shoqëri civile.

Forma e konsultimit: Takim publik.

Qëllimi i këshillimit publik	Diskutimi dhe mbledhja e rekomandimeve sa i takon Planit Vendor te Integritetit, 2025-2028.
Përshkrimi i çështjes	Plani Vendor i Integritetit është një mekanizëm institucional për parandalimin e korrupsionit dhe forcimin e integritetit të bashkisë. Ky instrument rrjedh nga objektivat strategjike për zhvillimin dhe miratimin e politikave antikorrupsion në nivel vendor të parashikuara në Strategjinë Ndërsektorale kundër Korrupsionit 2015-2023 dhe Planin e Veprimit 2020-2023 në zbatim të saj ¹ . Procesi i hartimit të këtij dokumenti u mbështet mbi Metodologjinë për Vlerësimin e Riskut të Integritetit për Njësitë e Vetëqeverisjes Vendore, e rekomanduar për t'u zbatuar nga Ministria e Drejtësisë. ²

	<p>Plani i Integritetit do të ketë një rol shumë të rëndësishëm në realizimin e objektivave të mëposhtme për Bashkinë Delvinë:</p> <ol style="list-style-type: none"> 1. Përmirësimi i mekanizmave rregullatorë dhe strategjikë të bashkisë në aspekte të veçanta të etikës dhe integritetit. 2. Konsolidimi i një administrate të qëndrueshme dhe profesionale nëpërmjet zhvillimit të burimeve njerëzore në bashki. 3. Rritja e efektivitetit të veprimtarisë së bashkisë nëpërmjet menaxhimit të riskut të integritetit në fusha të veçanta të përgjegjësisë. <p>Plani i Integritetit është përgatitur nga Grupi i Punës i caktuar në bashki.</p>
Kontaktet dhe afatet e dërgimit të komenteve, rekomandimeve, vërejtjeve;	<p>Komentet dhe rekomandimet tuaja jepen në adresat e emailit të Specialistes së Integritetit dhe koordinimit evropian në bashki: panoreaballaci@outlook.com dhe keshilibashkiakdelvine@gmail.com BRENDA DATËS 18.08.2025</p>
Shpjegim të procesit që do ndjekë dhe veprimet që do të ndërmerren Këshilli dhe administrata për të shqyrtuar rekomandimet nga publiku deri në marrjen e vendimit	<p>Pas mbledhjes së rekomandimeve, Këshilli i Bashkisë dhe Bashkia Delvinë do të ndjekë hapat si vijon:</p> <ol style="list-style-type: none"> 1. Realizimin nga ana e Sekretariatit të Këshillit ose personave përgjegjës në bashki të një Përmbledhjeje të Rekomandimeve dhe rezultateve të plota të takimit që përfshin të gjitha mendimet dhe propozimet që do të vijnë nga komuniteti dhe bërja publike e kësaj Përmbledhjeje; 2. Dërgimi i kësaj Përmbledhjeje Rekomandimesh Kryetarit të Bashkisë dhe çdo këshilltari të bashkisë; 3. Shqyrtimi nga ana e komisioneve të cdo rekomandimi dhe opinioni. 4. Publikimi i aktit në faqen e Këshillit të Bashkisë dhe në tabelat e informimit. 5. Njoftimi i administratës për aktin e miratuar. 6. Monitorimi i zbatimit të tij.
Data e publikimit	04.08.2025